

VENDIM
Nr. 9, datë 14.1.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT
PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË
POSAÇME DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të posaçme dhe të shërbimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT MBI HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË POSAÇME DHE TË SHËRBIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e shtetit të Kuvajtit, më poshtë të quajtura “palët kontraktuese”,

Me dëshirën e lehtësimit të hyrjes, daljes dhe lëvizjes së shtetasve të tyre, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kjo marrëveshje zbatohet për llojet e mëposhtme të pasaportave:

1. Për Republikën e Shqipërisë: për pasaporta diplomatike dhe shërbimi;
2. Për shtetin e Kuvajtit: për pasaporta diplomatike dhe të posaçme.

Neni 2

Shtetasit e të dyja palëve kontraktuese, mbajtës të pasaportave të llojeve, të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, hyjnë në territorin e palës tjetër kontraktuese pa viza dhe qëndrojnë për një periudhë maksimale prej 90 ditësh brenda 180 ditëve nga dita e hyrjes.

Neni 3

1. Shtetasit e palëve kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, të punësuar në misione diplomatike dhe konsullore, dhe në organizata ndërkombëtare me seli në territorin e palës tjetër kontraktuese, kanë të drejtë të hyjnë pa vizë në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen edhe për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta në të njëjtën familje dhe janë mbajtës të pasaportave të vlefshme të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Shtetasit e njëres palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, hyjnë, largohen dhe lëvizin transit në territorin e palës tjetër kontraktuese në çdo pikë kufitare të përcaktuar për lëvizje ndërkombëtare.

Neni 5

1. Shtetasit e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, respektojnë ligjet dhe rregullat e tjera të palës tjetër kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin e kësaj pale.

2. Kjo marrëveshje nuk i kufizon të drejtat e palëve kontraktuese për të refuzuar hyrjen ose për të mohuar qëndrimin e një personi të palës tjetër të cilin ajo e konsideron person *non grata*.

Neni 6

1. Me synimin mbrojtjen e sigurisë kombëtare, paqes dhe rendit publik dhe shëndetin e qytetarëve të tyre, palët kontraktuese kanë të drejtë të pezullojnë, pjesërisht ose plotësisht, zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Pala kontraktuese informon menjëherë palën tjetër në lidhje me vendimin për pezullimin e kësaj marrëveshjeje, pjesërisht ose plotësisht, ose për rihyrjen e saj në fuqi nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 7

1. Palët kontraktuese shkëmbejnë specimene të pasaportave përkatëse të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën për ndryshimin e specimeneve, 60 ditë para hyrjes së ndryshimit në fuqi.

3. Palët kontraktuese shkëmbejnë specimene të pasaportave të reja ose të ndryshuara të llojeve të përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë të dhëna në lidhje me përdorimin e tyre 60 ditë përpara prezantimit të specimeneve.

Neni 8

Mosmarrëveshjet, që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

Marrëveshja mund të zgjidhet me pëlqimin e të dyja palëve kontraktuese. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurat e përmendura në nenin 11 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 10

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të papërcaktuar kohe. Secila nga palët kontraktuese mund ta përfundojë marrëveshjen në çdo kohë, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja përfundon së zbatuari 90 ditë nga data e marrjes së njoftimit nga pala tjetër kontraktuese.

Neni 11

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se janë përmbushur të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionin e tyre kombëtar, për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Kuvajt, më 19.11.2014, në dy kopje origjinale në shqip, arabisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë të barasvlershme. Në rast interpretimesh të ndryshme, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ditmir Bushati

Ministër i Punëve të Jashtme

Për qeverinë e shtetit të Kuvajtit:

Sabah Khaled Al-Hamad Al-Sabah

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme